

AMBASADA E PARË E FËMIJËVE NË BOTË MEGJASHI - REPUBLIKA E MAQEDONISË

Linja SOS për fëmijë dhe të rinj

02 2465 316, 070 390 632

sos@childrensembassy.org.mk, info@childrensembassy.org.mk,

<https://www.facebook.com/SOSHELPLINEMEGJASHI/>

RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PUNËN E LINJËS SOS PËR FËMIJË DHE TË RINJ TË AMBASADËS SË FËMIJËVE MEGJASHI (janar - qershor 2021)

Muajt

janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor

Viti

2021

Vërejtjet hyrëse

Vërejtja e përgjithshme për këtë periudhë raportuese është se ishte punuar në kushte të jashtëzakonshme të pandemisë së KOVID-19. Thirrjet që i morëm në telefonin administrativ SOS 02 2465 316 u riorientuan në telefonin celular SOS për fëmijë dhe të rinj - 070 390 632.

Puna e telefonit SOS është e bazuar ngushtë në parimet e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, të cilat i theksojnë të drejtat e fëmijëve për privatësi dhe mbrojtje nga lëndimi. Qëllimi i linjës telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj është të sigurojë mbështetje për fëmijët në nevojë, të sigurojë forum për shkëmbimin e informacioneve dhe mbështetjes, mbështetjen e përfaqësimit dhe lobimit, promovimin e të drejtave të fëmijës dhe promovimin e linjës SOS si media për mbështetjen e fëmijëve.

Për herë të parë pas një kohe të gjatë, telefoni SOS funksionoi me kujdestari, përkatësisht ishte në dispozicion 24 orë në ditë falë ekipit SOS (Julia Vellkovska - operatore SOS, vullnetarët: Klementina Dobrevska, Marija Gjorgjioska, Mimoza Kostoska dhe Barlet Beqiri, si dhe Violeta Ilioska - supervizore në punën e telefonit SOS dhe Jordanka Ç. Trajkoska - koordinatore e telefonit SOS) dhe grupi i vullnetarëve dhe të cilët kanë dhënë kohën dhe njohuritë e tyre dhe akoma po japin. Nga ky vit, ekipit vullnetar dhe linjës telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj të Ambasadës së Fëmijëve Megjashi iu bashkuan edhe studentët e Institutit të Psikologjisë në Fakultetin Filozofik, UKM, anëtarë të Shoqatës së Studentëve të

Psikologjisë "Psihesko". Puna e ekipit SOS të Ambasadës së Fëmijëve MEGJASHI, si në të gjitha vitet e mëparshme, u mentorua nga Gordana Pirkovska Zmijanac, themeluese dhe u.d. drejtoreshë operative aktuale e APFB Megjashi.

A. Informacionet operative

Rajoni i punës: Maqedonia

Emri i linjës së ndihmës: Telefoni SOS për fëmijë dhe të rinj

Orari i punës i linjës SOS: 24/7

Kontaktet e përhershme: sos@childrensembassy.org.mk,

<https://www.facebook.com/SOSHELPLINEMEGJASHI/>

<https://www.facebook.com/detskaambasadamegjashi> <https://www.facebook.com/megjashi/>

E-mail në linjën SOS: sos@childrensembassy.org.mk

Telefonat e kontaktit në linjën SOS: +389 (0) 70 390 632 dhe / ose 02 2465 316 kujdestaria aktive 24/7 e linjës së telefonit SOS për fëmijë dhe të rinj


B. Njoftimet

1. Informacionet themelore për njoftimet

Në këtë pjesë është dhënë pasqyra e të dhënave të përgjithshme demografike për rastet (mosha dhe gjinia e fëmijëve sipas njoftimeve, si dhe përkatësia etnike), numri i njoftimeve të marra dhe numri i fëmijëve të përfshirë nga këto njoftime. Kjo pjesë, gjithashtu, përfshin edhe pasqyrën e mënyrës në të cilën i kemi marrë njoftimet - përmes telefonit administrativ, përmes faqeve në Fejsbuk të Ambasadës së Fëmijëve Megjashi, përmes postës ose me fjalime të drejtpërdrejta në lokalet e Megjashit.


NJOFTIMET

Në periudhën prej 6 muajsh, nga janari 2021 deri në qershor 2021, u morën gjithsej **151** njoftime. Numri i përgjithshëm i fëmijëve dhe të rinjve të përfshirë nga njoftimet është **223**, ndërsa në mënyrë plotësuese janë realizuar **226** biseda.



KANALI I KOMUNIKIMIT


Në këtë periudhë 6-mujore, komunikimi me njoftuesit në numrin më të madh u realizua përmes numrit administrativ (fiks) të Ambasadës së Fëmijëve Megjashi, më saktësisht janë pranuar **133** njoftime përmes telefonit, dhe më pas në mënyrë plotësuese u realizuan edhe **223** biseda, njoftimet që janë pranuar në e-mail për këtë periudhë janë **10**, njoftimet në faqen e FB-së janë **5**, dy njoftime janë pranuar me postë dhe një njoftim është parashtruar personalisht në lokalet e Megjashit.



MOSHA

Numri i përgjithshëm i fëmijëve dhe të rinjve sipas moshës dhe gjinisë

Grafiku jep pasqyrë për shpërndarjen e fëmijëve të cilëve u referohen thirrjet sipas moshës dhe gjinisë.



Sa i përket gjinisë, përfaqësimi është i barabartë midis djemve dhe vajzave, përkatësisht 100 femra dhe 99 meshkuj. Për sa i përket moshës, numri më i madh i meshkujve ndodhen në kategorinë prej 7-9 vjeç dhe 10-12 vjeç, ndërsa femrat janë më të shumta në grupmoshën prej 13-15 vjeç.

MJEDISI I TË JETUARIT

Sipas mjedisit ku jetojnë telefonuesit, siç shihet në **tabelën** më poshtë, numri më i madh i tyre ose **197** fëmijë jetojnë në mjedise urbane, **20** fëmijë janë të përfshirë nga njoftimet e njoftuesve që jetojnë në mjedisin rural, të panjohur **6** fëmijë.


Tabela 1. Fëmijët / të rinjtë të cilëve u referohet thirrja, sipas mjedisit ku jetojnë - urban dhe rural, të ndarë sipas gjinisë për këtë periudhë tremujore.

2021	meshkuj	femra	të pacaktuar	e panjohur	Gjithsej sipas mjedisit
Janar,	16	8	0	3	27
Shkurt,	9	10	0	0	19
Mars	14	14	0	3	31
Prill,	15	12	0	2	29
Maj	19	35	0	6	60
Qershor	17	13	0	1	31
Urban	90	92	0	15	197
Janar,	1	2	0	0	3
Shkurt,	2	2	0	4	8
Mars	0	0	0	0	0
Prill,	2	0	0	0	2
Maj	0	0	0	5	5
Qershor	1	1	0	0	2
Rural	6	5	0	9	20
Janar,	1	0	0	0	1

Shkurt,	0	0	0	0	0
Mars	0	0	0	0	0
Prill,	0	1	0	0	1
Maj	2	0	0	0	2
Qershor	0	2	0	0	2
E panjohur	3	3	0	0	6
Gjithsej sipas gjinisë	99	100	0	24	223

TELEFONUESIT SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

Lidhur me përkatësinë etnike të telefonuesve, siç tregohet në grafik, **124** nga numri i përgjithshëm janë maqedonas, **10** telefonues janë romë, **4** telefonues janë të përkatësisë etnike shqiptare. Vetëm **2** prej thirrjeve janë telefonuesit në grupet e tjera (grupet etnike) dhe për **11** persona, përkatësia etnike është e panjohur.




2. Pasqyra e të dhënave për shkeljen e të drejtave të fëmijëve sipas kategorisë së problemit

KATEGORITË E PROBLEMIT

Secili njoftim regjistrohet si një rast, pavarësisht nëse është kërkesë për informacionin ose problemin më serioz, arsyeja kategorizohet në formular të standardizuar sipas kornizës së Child Helpline International (CHI) e cila është rrjet global i linjave telefonike SOS për fëmijët duke punuar për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Telefoni SOS për fëmijë dhe të rinj Megjashi është anëtar i rrjetit që nga viti 2004. Ekzistojnë 11 kategori problemesh në këtë kuadër, përkatësisht shkelje të të drejtave të fëmijës dhe secili

prej 151 njoftimeve të marra numërohet në disa kategori problemesh në varësi të kompleksitetit të problemit.



Katër kategoritë më të zakonshme të problemeve të cilave u referohen njoftimet e marra janë si vijon:

- **MARRËDHËNIET FAMILJARE – 32%**

Si edhe në katër vitet e mëparshme, kjo kategori problemesh është në krye të arsyeve që i marrim njoftimet. Përsëritja e shkeljes së të drejtës për të parë të dy prindërit vazhdimisht në disa vitet e fundit dhe qëndrueshmëria e problemeve që ndodhin në telefonin SOS është një nga arsyet pse Ambasada e Fëmijëve Megjashi së bashku me Avokatin e Popullit dhanë edhe mbështetjen e Iniciativës për prindëri të përbashkët dhe aktivitetet e tyre. Numri më i madh i fëmijëve, madje 98, janë të përfshirë nga njoftimet që lidhen me problemin e shkeljes së të drejtës së fëmijës gjatë procedurave të divorcit dhe mosrespektimit të vendimeve të qendrave për punë sociale, bazuar në të shikuarit e fëmijës me prindin tjetër i cili nuk është kujdestar.

Jemi veçanërisht të shqetësuar për sindromën e fëmijës së tjetërsuar që ndodh te fëmijët e prindërve të divorcuar, pasi ka pasoja serioze në zhvillimin e këtyre fëmijëve dhe personalitetit të tyre. Lidhur ngushtë me këtë problem është edhe problemi i rrëmbimit të fëmijës nga një prej prindërve të divorcuar, problem që për herë të parë pas një kohe të gjatë u paraqit disa herë në telefonin SOS në gjysmën e parë të vitit 2021. Ambasada e Fëmijëve Megjashi një kohë të gjatë ka lobuar dhe ishte angazhuar për zbatimin e Konventës së Hagës mbi aspektet juridike civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, të cilën Maqedonia e nënshkroi në vitin 1991. Prandaj, në

rastet e rrëmbimit të fëmijëve nga njëri prind, autoritetet janë të detyruara të veprojnë në përputhje me Konventën dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në drejtim të respektimit të interesit më të mirë të fëmijës.

Ky nuk është vetëm numër alarmues, por vazhdon edhe si arsye mbizotëruese për paraqitjet në linjën SOS për 5 vjet, gjë që tregon se duhet të zbatohen masat dhe edukimet shtesë të prindërve gjatë ndarjes së tyre. Duhet t'u kushtohet vëmendje dhe vetëdije më e madhe për dëmin që e bëjnë me komunikimin e tyre të ndërsjellë konfliktual, më pas duke mos mbajtur konsideratë për nevojën që fëmija t'i dojë të dy prindërit në mënyrë të barabartë dhe për zhvillimin e tij të duhur ka nevojë për dashurinë dhe kujdesin e të dy prindërve, përveç nëse nuk vlerësohet ndryshe. Parandalimi i të shikuarit me njërin prind çon në shfaqjen e sindromës së fëmijës së tjetërsuar.

Me përvojën tonë shumëvjeçare në bashkëpunimin me qendrat për punë sociale, patëm mundësinë të shohim se numri i madh i rasteve dhe numri i pamjaftueshëm i resurseve njerëzore që duhet të përfshihen në mbajtjen dhe ndjekjen aktive të një rasti është problemi kryesor për trajtimin dhe mbrojtjen e parakohshme të fëmijëve. Problemi shtesë është edhe mungesa e trajnimeve përkatëse të të punësuarve në veprimin e fëmijëve, si dhe cilat janë masat që qendra i ka në kompetencën e saj. Ne jemi të hapur për bashkëpunim, për udhëzime që mund të mbështesim dhe të përmirësojmë situatën.

• **DHUNA – 27 %**

Në njoftimet për dhunë përfshihen 90 fëmijë dhe u referohen më tepër llojeve të dhunës:

- puna e dëmshme ose e rrezikshme, 1 fëmijë është prekur,
- dhuna midis moshatarëve, 1 fëmijë i prekur,
- shfrytëzimi ekonomik, keqpërdorimi i punës së fëmijëve, 2 fëmijë janë prekur,
- dhuna mendore / emocionale u referohet 21 fëmijëve,
- shpërfillja (pakujdesia), 10 fëmijë
- dhuna fizike - 33 fëmijë janë të përfshirë nga njoftimet në lidhje me këtë lloj të dhunës, që është numri më i madh i fëmijëve nga të gjitha njoftimet e dhunës
- dhuna seksuale - janë prekur 8 fëmijë nga njoftimet me të cilat paraqitet dhuna
- e pacaktuar / tjetër - 14 fëmijë

• **QASJA – 19%**

Gjithsej 63 fëmijë janë përfshirë në kategorinë e problemeve me qasjen në shërbimet dhe institucionet e ndryshme dhe kanë të bëjnë me problemet që lidhen me:

- Qasjen në arsim, 15 fëmijë.

Kjo kategori i përfshin fëmijët të cilët kishin qasje të kufizuar në arsim si rezultat i mospasjes së certifikatës së librit amë, mosposedimit të kartës së vaksinimit, zvogëlimit të kapaciteteve të punës së kopshteve të fëmijëve nga pandemia e KOVID-19, mjetit ndihmës teknik për ndjekjen e mësimi në internet, etj.

- Nevojat esenciale - nevojat themelore që nuk janë në dispozicion për 23 fëmijë.

Kjo kategori përfshin fëmijët që nuk kanë pasur mundësi të përmbushjes së nevojave më themelore si ushqimi, shtëpia, veshja, etj. Zakonisht bëhet fjalë për kategori vunerabile të familjeve që jetojnë në prag të varfërisë.

- Problemet me qasjen në mbrojtjen shëndetësore, pamundësinë për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore, mbrojtjen e domosdoshme shëndetësore, janë paraqitur 12 fëmijë me këtë problem.
- Njoftimet në lidhje me problemet me qasjen në shërbimet juridike - këshillat, nevoja për përfaqësimin juridik iu referua 5 fëmijëve.
- Shërbimet e shëndetit mendor iu referuan 2 fëmijëve.
- Kontaktet në lidhje me problemet me qasjen në shërbimet dhe ndihmën e ndryshme sociale ose ekonomike, numri i fëmijëve të përfshirë nga njoftimet është 4 fëmijë.
- Të papërcaktuar, tjetër 2 fëmijë (mospranimi në kopshtin e fëmijëve për shkak të mospasjes së kartës së vaksinimit)

• SHËNDETI MENDOR – 10%

Megjithëse përqindja e fëmijëve të kategorizuar në këtë kategori problemesh duket e vogël (15 fëmijë), ndërkaq rëndësia e shëndetit mendor të fëmijëve në zhvillim është shumë e lartë dhe mund të ndikojë në jetën e përgjithshme të fëmijës. Në rastet e paraqitura, vihet re se tek fëmijët mbizotërojnë zemërimi, zhgënjimi, emocionet që çojnë në sjellje agresive, dhe më shpesh shkak i kësaj gjendjeje psikologjike te fëmijët është qëndrimi i prindërve që lind nga divorcet. Mosmarrëveshja e prindërve për të parë, për të realizuar kontakte dhe takime të njërit prej prindërve me fëmijën ose fëmijët pas divorcit dhe pasi i kanë dhënë kujdestarinë njërit prej prindërve.

• PROBLEMET E TJERA - 12%

Kategoritë e problemit me numër të vogël të fëmijëve të përfshirë në njoftimet janë këto: diskriminimi dhe përjashtimi, shkolla, fëmijët e zhdukur, shëndeti fizik, seksualiteti dhe identiteti gjinor.

Në kategorinë Diskriminimi dhe përjashtimi kemi të regjistruar 12 raste dhe në rastin më të shpeshtë bëhet fjalë për përjashtimin e fëmijës nga grupet e ndryshme për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, por edhe diskriminimit në bazë etnike, keqkuptime midis të rriturve, etj.

Me kategorinë e shkollës nënkuptohen çështjet që lidhen me përballimin e detyrave të shkollës dhe performancave akademike, problemet, marrëdhëniet problematike ose ndërveprimi me mësimdhënësin ose autoritetet e shkollës, të cilat mund të kenë ndikim negativ te fëmija ose i riu, në mirëqenien e tij psikosociale. Në këtë kategori janë të regjistruar 11 fëmijë.

Kategoritë Fëmijët e zhdukur dhe Shëndeti fizik marrin pjesë me nga 2% në numrin e përgjithshëm. Kategoria Fëmijët e zhdukur përfshin rastet kur kemi person të mitur i cili ka ikur, përkatësisht është larguar vullnetarisht nga shtëpia ose institucioni ku është akomoduar dhe rrëmbimi i fëmijës nga njëri prind, përkatësisht rrëmbimi familjar. Në gjysmën e parë të këtij viti kemi 8 raste në këtë kategori. Megjithëse, numri është i vogël krahasuar me kategoritë e tjera të problemeve, është akoma i rëndësishëm për dy arsye. E para është se ky lloj i njoftimeve shfaqet për herë të parë në një periudhë të gjatë kohore, dhe arsyeja e dytë është se në pjesën më të madhe të njoftimeve bëhet fjalë për rrëmbimin e fëmijëve nga prindi (prindër të divorcuar). Në kategorinë Shëndeti fizik, janë regjistruar problemet në 8 raste, dhe ato i referohen HIV / AIDS, shëndetit riprodhues dhe problemeve mjekësore.

Kategoria Seksualiteti dhe identiteti gjinor - njoftimet në lidhje me çështjet e seksualitetit, orientimit seksual dhe identitetit dhe shprehjes gjinore. Dy fëmijë janë regjistruar në këtë kategori.

Tabela 2. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të prekur sipas kategorive të problemit për periudhën janar-qershor 2021


Kategoria e problemit	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	Gjithsej
Fëmijë të zhdukur	0	0	1	0	3	4	8
Dhunë	6	9	12	13	33	17	90
Shëndeti mental	1	10	5	1	13	2	32
Shëndeti fizik	0	0	0	1	0	7	8
Qasja	14	3	2	20	11	13	63
Diskriminimi dhe përjashtimi	1	0	2	9	0	0	12
Raportet familjare	24	15	14	13	25	15	106

Shkolla	0	0	1	2	6	2	11
Seksualiteti	0	0	2	0	0	0	2
Total	46	37	39	59	91	60	332

3. Aktivitete të ndërmarra

Aktivitetet që u ndërmorën në këtë periudhë 6 mujore në lidhje me gjendjen e zgjidhjes së problemeve të shprehura në raportimet, në numrin më të madh janë dhënë: rekomandime – për **68** fëmijë, udhëzime te autoritetet kompetente për zbatim të ligjit – **66** fëmijë, udhëzime në institucione tjera në vend ose jashtë saj – **60** fëmijë ose të rinj dhe udhëzime te këshilltarët në shkollat – për **8** fëmijë. **27** fëmijëve u është dhënë ndihmë me intervenime të drejtpërdrejta.

Gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve për zgjidhje të problemeve u realizuan kontakte dhe bashkëpunim me organizata, shërbime dhe institucione tjera dhe në numrin më të madh bashkëpunimi ishte i suksesshëm dhe u gjet zgjidhje.



Gjatë veprimit dhe ofrimit të mbështetjes, ekipi i telefonit SOS bashkëpunonte shpesh me qendrat për punë sociale, veçanërisht me Ekipin intervenues të Qendrës në Shkup, si dhe qendrat nga qytete tjera, Sektorin e punëve të brendshme, shkollat, Shoqatën e juristëve të rinj, Koalicionin për gjykim të drejtë, Qendrën e parë familjare si dhe faktorët dhe organizatat tjera për t'u ofruar mbështetje më të mirë dhe më efektive raportuesve.

Kur bëhet fjalë për udhëheqjen organizative të rasteve, qëllimi ynë kryesor është interesi më i mirë i fëmijës, përkatësisht veprimet duhet të jenë me rëndësi jetike në marrjen e vendimeve dhe zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me secilin fëmijë veçmas, por edhe për një grup caktuar të fëmijëve. Parimi i interesit më të mirë të fëmijës është një parim i përgjithshëm që në kuptimin e gjerë të fjalës shpie në realizmin e mirëqenies së fëmijës. Ekipi SOS përbëhet nga profile të ndryshme njerëzish: psikologë, avokatë, kriminolog, pedagog, punonjës social dhe së fundmi vullnetar - defektolog. Kjo larmi e ekipit na jep mundësi të shqyrtohet secili rast veç e veç nga disa aspekte dhe të gjendet zgjidhja më e mirë për zgjidhjen e tij.

HULUMTIM ONLINE PËR SHPREHITË DHE MËNYRAT E KOMUNIKIMIT TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE GJATË KËRKIMIT TË KËSHILLËS

Në drejtim të avancimit të vazhdueshëm të punës së linjës telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj dhe në drejtim të afrimit më të madh këtij grupi të synuar, Ambasada e Fëmijëve Megjashi kohë pas kohe anketon të rinjtë në lidhje me punën e tyre. Gjatë prillit dhe majit 2021, u bë një hulumtim në internet i fëmijëve dhe të rinjve të moshë 11 deri 18 vjet mbi shprehitë dhe mënyrat e preferuara të komunikimit gjatë kërimit të këshillave, fusha që kanë nevojë për këshilla dhe mbështetje, si dhe tema të interesit të tyre.

Në pyetësor u përgjigjën 431 studentë, nga të cilët 114 shqiptarë dhe 317 maqedonas (femra 247, meshkuj 177), 287 prindër, nga të cilët 214 janë femra dhe 69 meshkuj, 195 maqedonas dhe 92 shqiptarë dhe 113 mësues, nga të cilët 45 shqiptarë dhe 68 maqedonas. Shumica e tyre janë femra (91).

Nxënës

Më shumë se gjysma e studentëve janë të informuar për ekzistimin e linjës telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj, dhe pothuajse askush nuk njih asnjërin prej tyre që janë paraqitur në telefonoi. Dhe gatishmëria e nxënësve për t'u paraqitur në telefonin e njëjtë është me të vërtetë e vogël sepse ata mendojnë se nuk kanë nevojë, dhe ata nuk ndihen këndshëm kur flasin me një të huaj.

Mësimi online është problemi më i shpeshtë për nxënësit momentalisht, por nuk janë të panjohur për ta as problemet me gjumin, ndjenjën e pikëllimit dhe shqetësimit.

Nëse nxënësit kanë nevojë për të kërkuar ndihmë për ndonjë problem dhe të telefonojnë në linjën SOS për fëmijë dhe të rinj, do të jetë më e lehtë për ta të shkruajnë një mesazh në FB dhe Instagram, si dhe një SMS.

Që të lajmërohen në linjën SOS, studentët duhet të dinë këtë: të dinë që është e sigurt, të dinë se do të flasin me ekspertë, të mbrojnë të dhënat e tyre personale dhe të dinë se telefonojnë dikë që mundet vërtet t'u ndihmojë.

Prindërit

Shumica e prindërve të anketuar dinë për ekzistimin e linjës telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj dhe ata e dinë që fëmija i tyre nuk është lajmëruar në atë linjë, njëjtë siç nuk janë lajmëruar as vetë ato. Pothuajse dy të tretat do ta inkurajonin fëmijën e tyre të telefononte në linjën telefonike SOS po të kishte nevojë, por ka ende një përqindje e konsiderueshme e prindërve që kanë thënë se nuk do ta inkurajonin fëmijën. Si pengesë më e shpeshtë të cilën prindërit mendojnë se fëmijët/të rinjtë mund

ta kenë për të kërkuar ndihmë dhe për të përdorur një linjë të tillë SOS për fëmijët dhe të rinj, cekin frikën (nga pasojat e mundshme) dhe turpin (nga rrethi, nga shokët), mosinformimin dhe mosdija për ekzistimin e një linjë të tillë, mungesa e sigurisë në vete dhe mungesa e guximit, mentaliteti dhe paragjykimet, si dhe presionet nga rrethi dhe mosbesimin që e kanë ndaj të rriturve në përgjithësi.

Mësuesit

Shumica e mësuesve nga shkollat maqedonase e dinë se ekziston linja telefonike SOS; mësuesit nga shkollat shqipe pothuajse janë të ndarë për sa i përket informimit të tyre për ekzistimin e linjës. Vetëm një mësues njeh një nxënës që është paraqitur në linjën SOS, dhe më shumë se $\frac{3}{4}$ e mësuesve janë të gatshëm t'i udhëzojnë nxënësit të paraqiten në linjën SOS. Si arsye më të shpeshta të cilat i cekin mësuesit pse nxënësit nuk paraqiten në linjën SOS janë: mosinformimi, frika, turpi, mosbesimi, paragjykimet, mungesa e guximit. Askush nga mësuesit nuk ka kërkuar ndihmë nga linja telefonike SOS në rast kur kanë vërejtur problem te ndonjë prej nxënësve. Por, megjithatë shumica e tyre (60%) shprehën gatishmëri për t'u lajmëruar nëse vërejnë problem që nuk janë në gjendje ta zgjidhin.

Rekomandime nga mësuesit për linjën telefonike SOS:

Numri i linjës telefonike SOS të jetë publikisht i disponueshëm në të gjitha rrejtët sociale dhe në vende të dukshme në qytetet, shkollat, kafenetë etj. Mund të krijohet edhe aplikacion për celular, për disponueshmëri më të madhe dhe më të shpejtë."

„Mendoj se do të ishte mirë të ketë më shpesh pyetësorë për mësues, nxënës, prindër për tema të caktuara.“

„Konsideroj se linja telefonike SOS është ide e mirë dhe do të kishte funksionuar mirë në të ardhmen për mbështetjen e të rinjve.“

„Hapni sa më shpejt që mundet ueb afqe për informatat SOS që t'u ndihmoni fëmijëve sa më shpejt që mundet.“

Ky hulumtim është pjesë e projektit “T'i marrim të drejtat në duart tona”, në partneritet me Save the Children Kosovo i mbështetur financiarisht nga Qeveria e Suedisë.

Hulumtimi u realizua nga prof.dr. Eleonora Serafimovska dhe prof.dr. Marijana Markoviq, Universiteti Shën Cirili dhe Metodi, IHSPJ, Laboratoria psikologjike

Raportin e përgatitën:

Violeta Ilioska, *Supervizore e linjës SOS*

Julia Vellkovska, *Operatore e linjës SOS*

Marija Gjorgjioska, *Vullnetare e linjës SOS*

Jordanka Çerepnallkova-Trajkoska, *koordinatore e linjës SOS*

Redaktor: Dragi Zmijanac, themelues dhe kryetar i APFB Megjashi